

NJOFTIM PËR KONSULTIM PUBLIK

PËR PROJEKTLIGJIN “PËR KONTROLLIN E KUFIRIT SHTETËROR”

Ministria e Brendshme fton qytetarë, organizata të shoqërisë civile, ekspertë të fushës, shoqata dhe përfaqësues të tjerë të publikut të interesuar për të kontribuar përgjatë procesit të konsultimit publik të projektligjit “Për kontrollin e kufirit shtetëror”.

Ministria e Brendshme mirëpret:

Komente të përgjithshme publike mbi përcaktimet e projektaktit, kryesisht mbi:

- Fuqizimin e rolit të vetëqeverisjes vendore në sigurinë publike;
- Përfshirja aktive e komunitetit në çështjet e sigurisë publike.

Kontributet tuaja do të konsiderohen përgjatë procesit të përmirësimit të mëtejshëm të projektligjit.

Ministria e Brendshme do të përmbledhë të gjitha sugjerimet dhe komentet tuaja dhe do të japë sqarime për mënyrën se si ato janë reflektuar në projektakt, edhe në rast se mendimet nuk reflektohen.

Kohëzgjatja e konsultimeve:

Konsultimi publik do të zgjasë 20 ditë pune, nga data 19 gusht 2024 deri më 16 shtator 2024.

Si të përgjigjeni:

Mund të merrni pjesë në procesin e konsultimeve publike duke dërguar komente/kontribute për projektin:

- Duke plotësuar formularin online të Regjistrin Elektronik për projektligjit, në adresën elektronike: <http://www.konsultimipublik.gov.al>;
- Me email duke dërguar propozimet/sugjerimet tuaja në adresën e koordinatorit të konsultimit publik për Ministrinë e Brendshme, Sara Shameti, në adresën: Sara.Shameti@mb.gov.al

Kontakti:

Të dhënat e kontaktit të koordinatorit përkatës për konsultime publike dhe/ose të ndonjë personi tjetër të cilit i drejtohen pyetjet:

Datat dhe vendet e takimeve publike:

Projektligji “Për kontrollin e kufirit shtetëror”, ka si qëllim përafrimin e plotë të legjislacionit të Bashkimit Evropian në fushën e kontrollit kufitar dhe mbikëqyrjes së kufirit shtetëror.

Konkretisht, projektligji synon përafrimin me rregulloren (BE) 2016/399 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, datë 9 mars 2016, “Mbi Kodin e Bashkimit Evropian që përcakton rregullat e regjimit të lëvizjes së personave përmes kufijve (Kodi i Kufijve Schengen)”, numri CELEX32016R0399, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Evropian, seria L, nr.77, datë 23.3.2016. Si dhe direktivat e reja të rregullores (BE) të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit.

Në hartimin e këtij projektligji ka kontribuar Policia e Shtetit/Departamenti për Kufirin dhe Migracionin, si dhe Ministria e Brendshme/Drejtoria e Programimit, Standardizimit dhe Harmonizimit të Kuadrit Rregullator, Drejtoria e Politikave Strategjike për Rendin & Sigurinë Publike, Drejtoria e Përgjithshme e Doganave/Ministria e Financave, AKU/ Ministria e Bujqësisë dhe e Zhvillimit Rural, Ministria e Mbrojtjes/QNOD.

Nëpërmjet Urdhrit të Ministrit të Brendshëm, nr. 26, datë 19.01.2024, u ngrit Grupi i Punës “Për hartimin e projektligjit “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 71/2016 “Për kontrollin kufitar””, i ndryshuar, të cilin e kryesoi zv. ministri përgjegjës për kufirin. Ky grup u mbledh disa herë për diskutime, deri në draftimin e tekstit të këtij projektligji, me përfaqësues nga Policia e Shtetit, MEPJ, AKU dhe Doganat.

Sfondi i propozimit legjislativ

Projektligji “Për kontrollin e kufirit shtetëror” është hartuar si një domosdoshmëri për plotësimin e paketës së akteve ligjore që synojnë përafrimin e legjislacionit të Bashkimit Evropian në fushën e kontrollit kufitar.

Projektligji “Për kontrollin e kufirit shtetëror”, të ndryshuar, është parashikuar në katërmujorin e dytë të vitit 2024, i cili në mënyrë të përmbledhur përmban ndryshimet e mëposhtme:

Aktualisht, kemi në fuqi disa ligje që kanë lidhje me kufirin shtetëror, kontrollin kufitar dhe mbikëqyrjen e kufirit, të cilat janë:

1. Ligji nr. 8771, datë 19.04.2001 “Për kufirin shtetëror të Republikës së Shqipërisë”.
2. Ligji nr. 9861, datë 24.01.2008 “Për kontrollin dhe mbikëqyrjen e kufirit shtetëror” i ndryshuar.
3. Ligji nr. 71/2016, “Për kontrollin kufitar” i ndryshuar.

Propozimet

Objektivat që synohen të arrihen nëpërmjet këtij projektligji janë kryesisht, por pa u kufizuar, përforsimi i kontrollit dhe mbikëqyrja e kufijve, parandalimi dhe goditja e krimit ndërkufitar, parandalimi i migracionit të paligjshëm, rritja e parametrave të sigurisë kufitare dhe kombëtare:

- Rritja e nivelit të përputhshmërisë me standardet evropiane dhe të Schengen, në aspektin legjislativ, administrativ e institucional në fushën e menaxhimit të integruar të kufijve, veçanërisht në fushën e kontrollit dhe mbikëqyrjes së kufirit, forcimi i bashkëpunimit mes agjencive dhe bashkëpunimit ndërkombëtar.
- Krijimi i Qendrës Kombëtare për Menaxhimin e Integruar të Kufirit, në përputhje me Rregulloren e EUROSUR.
- Rregullore e miratuara me VKM mbi përcaktimin e rregullave të trafikut lokal të kufirit, procedurave të lëshimit, formës, elementëve të sigurisë dhe specifikimeve teknike të lejes së trafikut lokal të kufirit.
- Rritja e sigurisë në zonën e verifikimit kufitar;
- Përmirësimi i Sistemit për mbikëqyrjen e hapësirës detare, kontrollit kufitar dhe kërkim shpëtimit në det.
- Përcaktimi i rregullave të qarkullimit lokal kufitar, duke sanksionuar zbatimin e qarkullimit lokal kufitar, regjimin e qarkullimit lokal kufitar, pajisjen me lejen e qarkullimit lokal kufitar, kushtet, përmbajtja, forma dhe elementet e sigurisë së lejes së qarkullimit lokal kufitar si dhe lehtësimi i qarkullimit lokal kufitar.

Pyetjet

Jeni të ftuar të jepni komentet dhe kontributet tuaja për të gjitha aspektet e projektligjit të propozuar. Për më tepër, ne kemi zgjedhur pyetjet e mëposhtme ku kontributi juaj do të jetë veçanërisht i vlefshëm, dhe të cilave mund t'i përgjigjeni duke plotësuar një pyetësor të shkurtër në internet.

- A mendoni se projektligji do të përmirësojë sistemin e mbikëqyrjes së hapësirës detare, kontrollit kufitar dhe kërkim-shpëtimit në det?
- A mendoni se zbatimi i këtij projektligji do të sjellë bashkëpunim të zgjeruar ndër-institucional në menaxhimin e integruar të kufijve për të përmirësuar qarkullimin ndërkufitar, luftën ndaj krimit ndërkufitar, mbrojtjen e jetës, shëndetit dhe pronës?